



# Sigurimet tradicionale bujqësore Doracak për vlerësimin e dëmeve nga breshëri tek speci

Projekti për Financimin e Bujqësisë për Evropë dhe Azi Qendrore

IN COOPERATION WITH:



**WORLD BANK GROUP**

**IFC** International  
Finance Corporation

## Përmbajtja

1.	Qëllimi i doracakut/udhëzuesit të vlerësimit të dëmeve.....	3
2.	Objektivat e Doracakut së Metodologjisë të Vlerësimit të Dëmeve .....	3
3.	Sigurimi Bujqësor – Kufiri i dëmshpërblimit/ Kostoja e prodhimit .....	3
4.	Përshkrimi i teknologjisë intensive të specit.....	4
4.1	Tipet e prodhimit.....	4
4.2	Numri i frutave të specave për trup.....	4
4.3	. Varietetet dhe hibridet e specit .....	4
5.	Rreziqet në bujqësi.....	4
5.1.	Rreziqet e siguruara .....	4
5.1.1.	Breshëri - definimi i rrezikut.....	4
5.2.	Rreziqet e pasiguruara.....	5
6.	Procedurat e vlerësimit të dëmit .....	7
6.1.	Njoftimi i ngjarjes .....	7
6.2.	Hapat e vlerësimit të dëmeve dhe procedurat .....	7
6.3.	Dokumentet e nevojshme për procesin e vlerësimit të dëmeve në terren.....	8
6.4	Pajisjet e nevojshme për procesin e vlerësimit të dëmeve .....	8
6.5.	Prezantimi i vlerësuesit të dëmeve.....	11
6.6.	Konfirmimi i Koordinatave të GPS-it dhe Vendosija e Koordinatave.....	11
6.7.	Procesi identifikimit të dëmeve.....	11
6.8.	Veprimet e Vlerësuesit të dëmeve gjatë vizitës në terren.....	11
6.9.	Numri i mostrave për qëllime të vlerësimit të dëmeve .....	12
7.	Metodologjia e vlerësimit të dëmeve pas paraqitjes së breshërit .....	14
7.1.	Klasifikimi i frutave të specit pas ngjarjes së breshërit.....	15
7.2.	Fotografitë e Kërkueshme nga Vlerësuesi i Dëmeve .....	18
8.	Përfundimi i procesit të vlerësimit të dëmeve.....	19
8.1	. Kalkulimi i dëmeve/ Rezultatet e vlerësimit të dëmeve .....	20
	Shtojca 1. Forma e njoftimit të dëmit.....	20
	Shtojca 2. Formulari i Ngastrës form.....	22
	Shtojca 3. Raporti i inspektimit të vlerësimit të dëmeve .....	23
	Annex 4. Report on calculation of indemnities .....	24
	.....	24

## 1. Qëllimi i doracakut/udhëzuesit të vlerësimit të dëmeve

Ky dokument përcakton rregullat dhe procedurat, të cilat duhet të respektohen nga një vlerësues i dëmeve gjatë kryerjes së një vlerësimi të dëmeve (humbjeve) të specit të siguruar me sigurim bujqësor. Doracakun përshkruan metodat për përcaktimin e dëmeve, llogaritjen, afatet kohore, dhe dokumentet e nevojshme.

Doracakun i vlerësimit të dëmeve do të ndihmojë vlerësuesit e dëmeve për përcaktimin e dëmeve në sigurimet bujqësore tradicionale për kultivuesit e specit. Mbulimi i sigurimeve do të fillojë nga shfaqja e fazës së formimit të frutave deri në periudhën e vjeljes dhe e shprehur në datat e kalendarit duhet të jetë 1 korrik deri më 30 shtator. Nuk do të ketë mbulim sigurimi nga mbjellja e fidanëve të specave - e ashtuquajtura periudha vegjetative deri në fazën fillestare të lulëzimit sepse nëse ndodh breshëri në këtë periudhë fermerët do të kenë më shumë përfitim ekonomik nëse do të zëvendësojnë fidanët e dëmtuar të specave me fidanë të reja. Prandaj këshillohet që kultivuesit e specave që aplikojnë teknologji intensive, të mbjellin 1 kg më shumë farë dhe të prodhojnë fidanët e tyre në rast se breshëri ndodh gjatë kësaj periudhe. Ka ende kohë të mjaftueshme për të zëvendësuar fidanët e dëmtuar në varësi të rajonit, në disa rajone deri më 10 qershor dhe në disa rajone deri më 30 qershor.

Rekomandimet metodologjike janë zhvilluar për programin e sigurimit bujqësor të ashtuquajtur një rrezik (breshër) për specin për periudhën e ciklit të frutifikimit. Në këtë program mund të sigurohen vetëm sipërfaqet me kultivim intenziv të specit. Dokumenti nuk jep rekomandime lidhur me vlerësimin e dëmeve për kultivuesit e specit në teknologji tradicionale dhe gjysëm intenzive.

## 2. Objektivat e Doracakut së Metodologjisë të Vlerësimit të Dëmeve

Qëllimi i këtij doracakut është që të udhëzojë ekspertët (vlerësuesit e ardhshëm të dëmeve) të cilët do të merren me vlerësimin e dëmeve për kultivuesit e specit. Përshkruan procedurat që nevojiten të ndjekën për vlerësimin e dëmeve. Ky doracak shërben vetëm për Poliset e Sigurimit bujqësor tradicional të specit. Ky doracak gjithashtu do të ndihmojë ekspertët të kenë qasje të njëtrajtshme gjatë procedurave të vlerësimit si dhe renditjen e plotësimin të dokumenteve. Kjo do të mundësojë një transparencë më të madhe, e cila do të rrisë kredibilitetin për fermerët dhe kompanitë e sigurimeve, pas vlerësimit të dëmeve në sipërfaqet e mbjella me spec të prekura nga breshëri.

## 3. Sigurimi Bujqësor – Kufiri i dëmshpërblimit/ Kostoja e prodhimit

Për qëllime të sigurimit tradicional, kufiri i dëmshpërblimit do të jetë kufiri i kostos së prodhimit për specin e kultivuar sipas teknologjis intensive. Kufiri i kostos së prodhimit për kultivuesit intensive të specit për 1 hektarë është llogaritur në shumën prej 3,500€. Të gjitha pagesat e dëmshpërblimit për poliset e sigurimit të specit do të bazohen në këtë shumë të siguruar.

## 4. Përshkrimi i teknologjisë intensive të specit

### 4.1 Tipet e prodhimit

Për qëllime të sigurimit tradicional, do të konsiderohen vetëm teknologjia intensive kultivimit të specit. Karakteristikat e prodhimit të teknologjisë intensive janë si mëposhtë:

Fidanet e specit janë të mbjellura në një strukturë të dendur në një distancë mes rreshtash prej 30.6 – 0.7m dhe në një distancë të fidaneve të specit brenda rreshtit prej 0.20 – 0.25m. Në një sipërfaqe prej një hektari, një fushe e specit e këtij tipi të tillë, varësisht edhe prej modelit të kultivimit, ka të paktën 60,000 – 70,000 fidane speci, si parakusht për marrjen e rendimentet të lartë dhe të qëndrueshëm. Përmishtet intensive përfshijnë sistemin e ujitjes, sistemin e plehërimit, folinë e zezë për mbulimin e tokës dhe zbatimin e masave të reja agroteknike.

### 4.2 Numri i frutave të specave për trup

Një bimë speci mund të prodhojë numër të ndryshëm të frutave të specit, varet nga varietetet dhe hibridet dhe kjo qasje duhet të zbatohet për të gjitha llojet e varieteteve dhe hibridet e specit të kultivuar në Kosovë:

Varietetet kryesore ose hibride e specit të kultivuara në Kosovë <sup>1</sup>	Numri mesatar i frutave të specit për bimë (copë)
<b>Speci tipit zile</b> (Somborka, Babura, Amy F1, Anita, Barbie F1, Beladonna F1, Bibic F1, Amanda)	11
<b>Speci tipit banane</b> (var. Duga bela, Dora, Bounty F1, Bardhi F1, Interno F1, Fortesa f1, Kun F1, Beli Biser, Bingo F1, Alisa F1, Silvija, Ekstaza, Belinda)	12
<b>Speci kuq industrial</b> (Kurtovska Kapija, Vesh Elefanti, Amfora, Atris F1, Green field F1)	9
<b>Speci feferon</b> (feferoni djegës I kuq, feferoni verdh djegës, feferoni spiral I ëmbël, Dzinka, Famoza f1 djegës, ).	16

### 4.3. Varietetet dhe hibridet e specit

Polica e Sigurimit të Specit do të mbulojë humbjet për të gjitha varietetet dhe hibridet e specit që kultivohen në territorin e Republikës së Kosovës. Disa nga varietetet dhe hibridet më të zakonshme të specit në Kosovë përmenden në tabelën më lart.

## 5. Rreziqet në bujqësi

### 5.1. Rreziqet e siguruara

#### 5.1.1. Breshëri - definimi i rrezikut

Breshëri është një fenomen i zakonshëm meteorologjik, i cili është vazhdimisht i pranishëm me një frekuencë dhe ashpërsi të lartë. Zakonisht ndodh gjatë "**muajve të ngrohtë të vitit**", duke

<sup>1</sup> Kjo list e varieteteve dhe hibrideve të specit duhet të azhurnohet vazhdimisht nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë Zhvillimit Rural (MBPZHR) sipas kërkesave

Sigurimet Bujqësore Tradicionale - Doracak për vlerësimin e dëmeve nga breshëri tek kultivuesit intensiv të specit

filluar nga Maji deri në Gusht. Frekuenca më e madhe e breshërit ndodh gjatë muajit maj dhe qershor, por në një kuptim më të gjerë mund të ndodhë edhe më herët, si fundi i prillit deri në fund të shtatorit. Zakonisht ndodh në orët e pasdites, diku rreth orës 13:00. deri në orën 20:00. dhe zgjat maksimalisht 10 minuta. Zonat e prekura më shpesh nga breshëri duket të jenë të ngushta dhe në shirita të ngushtë.

Zakonisht në praktikë obligimet e siguresit për pagesat e dëmshpërblimit fillojnë nga lulëzimi/faza fillestare e formimit të frytit deri në fund të periudhës së vjeljes apo 30 shtatorit. Breshëri mund të dëmtojë frutat, gjethet, sythat dhe llastarët e bimës së specit, megjithatë sigurimi zakonisht mbulon vetëm frutat e dëmtuara edhe pse fletët, sythet dhe llastarët luajnë rol shumë të rëndësishëm fiziologjik në aktivitetet jetësore të bimëve të specit.

## 5.2. Rreziqet e pasiguruara

Rreziqet e pasiguruara që nuk do të mbulohen nga polisat e sigurimit të specit janë si më poshtë: ka shumë sëmundje dhe dëmtues të cilët mund të ndikojnë negativisht në prodhimtarin e specit: Sëmundjet më të zakonshme të bimëve të specit janë: ndezja bakteriale, antraknoza, vrugu I rrënjëve, hiri specit dhe si dëmtuesit - morrat - barërat e këqija. Sidoqoftë, këto rreziqe mund të zbuten me aplikimin e pesticideve të përshtatshme, fungicideve dhe herbicideve dhe praktikave të mira të menaxhimit të fermave. Disa sëmundje mund të humbasin dhe mund të përsëriten. Rreziku konsiderohet i lartë sepse zona e prodhimit të specit është e përqendruar në të njëjtin rajon dhe kjo mund të shkaktojë përhapjen e sëmundjeve në fermat e tjera si Anthracnose.

Ndezja bakteriale e specit



Hiri Specit



Antraknoza



Morrat



Barojat e keqija

Sigurimet Bujqësore Tradicionale - Doracak për vlerësimin e dëmeve nga breshëri tek kultivuesit intensiv të specit



## 6. Procedurat e vlerësimit të dëmit

### 6.1. Njoftimi i ngjarjes

Pas ngjarjes së breshërit, veprimet dhe afatet e mëposhtme duhet të respektohen:

1. Fermeri është i detyruar të njoftojë dëmin **me shkrim** brenda 48 orëve nga data e paraqitjes duke plotësuar formularin e njoftimit të dëmit, të nënshkruajë dhe ta dërgojë tek Kompania e Sigurimeve, përmes postës elektronike ose ta dorëzojë në zyrën më të afërt të Kompanisë së Sigurimeve.

Forma e njoftimit të dëmit do të sigurohet nga Kompania e Sigurimeve gjatë procesit të sigurimit dhe do të publikohet në faqen e internetit të Siguruesve dhe Ministrisë, por gjithashtu do të jetë në dispozicion sipas kërkesës së fermerit në çdo kohë. **Formulari i Njoftimit të Dëmeve bujqësore mund të gjendet në Shtojcën 1, në fund të këtij doracaku.**

2. Formulari i Njoftimit të Dëmeve bujqësore duhet të jetë me datë të saktë dhe të nënshkruhet nga fermeri ose personi i tij i autorizuar.

### 6.2. Hapat e vlerësimit të dëmeve dhe procedurat

Meqenëse fusha e mbjellë me spec është një kulturë njëvjeçare dhe fermeri ka shprehur interesim të sigurohet nga breshëri, Siguruesi dhe fermeri duhet të kenë mirëkuptim dhe besueshmëri dhe të merret nën mbulim kultura specit pa një vizitë paraprake. Kompania e Sigurimeve do të shqyrtojë formularin e njoftimit të dëmit të paraqitur nga fermeri dhe do të kontrollojë nëse polisa është e pranueshme për dëmshpërblim.

Pasi kompania e sigurimit konfirmon vlefshmërinë dhe mbulimin e polisës së sigurimit, kërkesa duhet të regjistrohet dhe të miratohet për vlerësimin e dëmeve. Në këtë fazë, kompania e sigurimeve duhet të caktojë një vlerësues të dëmeve për të kryer procesin e vlerësimit të dëmeve për këtë kërkesë të veçantë jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e breshërit. Vlerësuesi i dëmeve duhet të zgjidhet nga lista e vlerësuesve të dëmeve të certifikuar dhe të autorizuar brenda MBPZHR-së. Pastaj duhet të ndjekën hapat e mëposhtëm:

1. Fermeri dorëzon formularin e njoftimit të dëmit tek Kompania e Sigurimeve;
2. Kompania e Sigurimeve shqyrton formularin e kërkesës dhe cakton vlerësuesin e dëmit;
3. Vlerësuesi i dëmeve duhet të mbledhë të gjithë informacionin dhe dokumentet e nevojshme nga Siguruesi para vlerësimit të dëmit siç përshkruhet në pikën 6.3.;
4. Vlerësuesi i dëmit pasi të ketë marrë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm nga Kompania e Sigurimeve, do të llogarisë para-vlerësimin e dëmit përpara se të bëjë vlerësimin e dëmeve në terren. Para-vlerësimi i dëmeve do të bazohet në dokumentacionin e siguruar nga Kompania e Sigurimeve, por vlerësimi i vërtetë i dëmeve në terren do të bëhet jo më vonë se 10 ditë pas paraqitjes së breshërit.
5. Para kryerjes së vizitës në terren, vlerësuesi i dëmeve do të kontaktojë fermerin për të caktuar datën dhe vendin e saktë për vizitë në terren. Gjeoportali i mëposhtëm mund të jetë shumë i dobishëm për vlerësuesin e dëmeve për të gjetur vendndodhjen e saktë të fushës së specit: <http://geoportal.rks-gov.net/en/filimi>.
6. Pasi të organizohet vizita, Vlerësuesi i Dëmeve do të njoftojë kompaninë e sigurimeve, në mënyrë që ata të mund të ndjekin përmbushjen e aktiviteteve nga vlerësuesi i dëmeve.

### 6.3. Dokumentet e nevojshme për procesin e vlerësimit të dëmeve në terren

Dokumentet e mëposhtme janë të nevojshme për procesin e vlerësimit të dëmeve në terren:



- Polisa e sigurimit,
- ID e fermerit,
- Certifikata Kadastrale dhe Kopja e Planit,
- Forma për njoftimin e dëmit,
- Formulari i planit të fushës së mbjellur (kjo duhet të nënshkruhet nga të dyja palët),
- Raporti i inspektimit (kjo duhet të nënshkruhet nga të dy palët).

### 6.4 Pajisjet e nevojshme për procesin e vlerësimit të dëmeve


Për përfundimin me sukses të punës, procesi i vlerësimit të dëmeve duhet të shoqërohet me pajisjet (mjetet) e mëposhtme:

- Marrësi GPS ose pajisje të tjera me softuer të përshtatshëm; GPS është një sistem kompleks elektronik-teknik i përbërë nga një grup i pajisjeve tokësore dhe hapësinore të përdorura për të përcaktuar koordinatat gjeografike (gjatësia, gjerësia dhe lartësia mbi nivelin e detit). GPS navigator përdoret për fiksimin e koordinatave të fushave të ekzaminuara. Kompjuteri i dorës me GPS-marrës, nëse instalohet softueri i duhur, lejon jo vetëm rregullimin e koordinatave gjeografike, por edhe llogaritjen e zonës së matur.





- Metër me gjatësi prej 10 ose më shumë metra në gjatësi - mjet për matjen e gjatësisë dhe matjeve në terren;



- Kamera me aftësinë për të shfaqur datën e marrjes së fotografive (dhe koordinatat GPS) me një rezolucion prej të paktën 10 megapiksel ose;
- Kamera, GPC dhe llogaritësi mund të kombinohen në një pajisje;



- Një tabletë, një fletë kartoni të bardhë, një fletore dhe një laps për regjistrimet dhe shenjat në terren;



- Dy kuti të zbrazëta kartoni;



Sigurimet Bujqësore Tradicionale - Doracak për vlerësimin e dëmeve nga breshëri tek kultivuesit intensiv të specit

- Një kalkulator;



#### 6.5. Prezantimi i vlerësuesit të dëmeve

Pas mbërritjes në vendndodhjen e dakorduar, vlerësuesi i dëmit duhet të paraqesë kredencialet dhe autorizimin nga Kompania e Sigurimeve për të kryer inspektimin. Vlerësuesi i dëmit do të informojë fermerin për vizitën, çfarë do të bëhet gjatë procesit të vlerësimit të dëmeve dhe ta inkurajojë atë të marrë pjesë në çdo veprim për hir të transparencës. Përfshirja e fermerit është e detyrueshme që vlerësimi i dëmeve të bëhet siç duhet.

#### 6.6. Konfirmimi i Koordinatave të GPS-it dhe Vendosja e Koordinatave

Për të vendosur koordinatat GPS-it në një mënyrë më efektive dhe më të saktë, kërkohet që vlerësuesi i dëmeve të hyjë 20 m brenda sipërfaqes së mbjell me spec. Nuk lejohet të vendosen koordinatat e sipërfaqes së mbjell me spec jashtë sipërfaqes (për shembull, në rrugën pranë sipërfaqes së mbjell me spec, në një parcelë të afërt ose një parcelë afër që nuk i përket fermerit). **Ky hap është shumë i rëndësishëm që të kryhet si duhet.**

#### 6.7. Procesi identifikimit të dëmeve

Vlerësuesi i dëmeve, i shoqëruar dhe i mbështetur nga fermeri, do të fillojnë së bashku procesin e identifikimit të pemishtes së dëmtuar duke shënuar zonën e dëmtuar. Në këtë fazë, vlerësuesi i dëmit është i detyruar të plotësojë me dorë Formularin e planit të parcelës. **Shtojca 2. Formulari i planit të parcelës.**

#### 6.8. Veprimet e Vlerësuesit të dëmeve gjatë vizitës në terren

Vlerësuesi i dëmeve duhet të shqyrtojë hartat e fushave dhe të përcaktojë rrugën optimale për lëvizjet e tij. Së pari, në parcelën e specit të siguruar nga breshëri, Vlerësuesi i dëmeve dhe fermeri vlerësojnë nëse e gjithë zona e siguruar nga breshëri është goditur nga breshëri, nëse gjejnë se vetëm një pjesë e caktuar e parcelës është goditur nga breshëri, atëherë ata duhet të përcaktojnë dhe masin sipërfaqen e dëmtuar nga breshëri dhe menjëherë do të fillojnë të plotësojnë në Formularin e Paraqitjes (Shtojca 2: Formulari i Plotë i Paraqitjes). Kjo procedurë do të lejonte shqyrtimin e të gjitha pjesëve të dëmtuara për përcaktimin e dëmeve brenda periudhës

më të shkurtër. Rekomandohet të bëni fotografi gjatë vlerësimit të dëmit duke treguar përfshirjen e fermerit dhe vlerësuesit të dëmeve.



Vlerësuesi i dëmeve



Farmeri dhe Vlerësuesi i dëmeve

Raporti i Inspektimit duhet domosdoshmërisht të përmbajë kodet e fazës së vegetacionit të prodhimit të mollës siç përshkruhet në tabelën 1 e mëposhtme:

**Tabela 1. Fazat dhe kodet e prodhimit të specit**

Fazat e zhvillimit të kulturës së specit	Kodimi fazës vegetative
Frutifikimi	1

#### 6.9. Numri i mostrave për qëllime të vlerësimit të dëmeve

Për parcelën e dëmtua të specit me madhësi 1 ose më pak hektarë (1 & <1), numri i mostrave të rekomanduara duhet të jetë 5, kjo do të thotë 5 pikë dhe për secilën pikë - 5 bimë speci (sepse në 1 m<sup>2</sup> - mbillen 5 bimë speci). Mostra duhet të përfshijë numrin e bimëve të specit në 1 m<sup>2</sup>, normalisht bazuar në teknologjinë intensive të kultivimit të specit dhe duhet të zgjidhen sipas metodës së “zarfit të mbyllur” siç tregohet në figurën mëposhtë:



Ju lutemi referojuni tabelës së mëposhtme për numrin e saktë të mostrave për madhësi të ndryshme të sipërfaqes së mbjell me spec:

**Tabela 2. Numri i mostrave për ha**

Sipërfaqja e një fushe (me spec)	Numri minimal i mostrave të kërkuara
1 hektarë dhe më pak	5
Çdo+1 hektarë	+1 mostër shtesë
2 hektarë	6
3 hektarë	7
4 hektarë	8
5 hektarë	9

## 7. Metodologjia e vlerësimit të dëmeve pas paraqitjes së breshërit

Pas paraqitjes së breshërit, Metodologjia aplikohet për vlerësimin e dëmeve maksimum 10 ditë pas paraqitjes së breshërit. Vlerësuesi i dëmeve do të zgjedhë numrin e bimëve të specit - mostrën sipas pikës 6.7. Përzgjedhja e mostrave – pikat mostrale të bimëve të specit duhet të plotësohen së bashku ndërsa frutat e dëmtuara të specit nga mostra (pika) duhet të merren në të gjitha anët e bimëve të specave në një mostër (vetëm frutat e specave të dëmtuar): duhet të vjelni një bimë speci nga fermeri dhe bima tjetër e specit duhet të vjelet nga vlerësuesi dëmit, (në total 5 bimë për 1 mostër (pikë)).

Vetëm frutat e specit të dëmtuara duhet të vjelen dhe të vendosen të paktën në dy gajbe kartoni, sepse duhet të merren në konsideratë nga 5 pika mostrale për hektarë, secila mostër përmban 5 bimë speci dhe secila bimë speci përmban maksimumi 10 fruta speci të dëmtuara. Të dy (fermeri dhe Vlerësuesi i dëmeve) do të fillojnë të rikontrollojnë frutat e dëmtuara në bimën e specit dhe t'i vendosin në gajben prej kartoni bosh, vetëm të dëmtuarit dhe të l rinumërojnë. Ju lutemi referojuni pikës 7.1. për informacion mbi klasifikimin e frutave të goditur nga breshëri.

Të gjithë frutat e mbledhura të dëmtuara duhet të numërohen në dy gajbe kartoni (frutat e dëmtuara të specave të hedhura duhet të hidhen në fushë), të gjitha gjetjet duhet të shkruhen në një letër të pastërt që Vlerësuesi i dëmeve duhet të ketë në dispozicion. Kur të numërohen të gjithë frutat e dëmtuar, Vlerësuesi i dëmeve do të shënojë numrin e frutave totale të dëmtuara. Më pas, ata do të llogarisin numrin mesatar të frutave për mostër dhe do të mbajnë shënime gjithashtu. Formula e mëposhtme duhet të përdoret për të përcaktuar përqindjen (%) e humbjeve për mostër:

Numri i përgjithshëm i frutave të specit të dëmtuar në pesë pikat mostrale / numri i përgjithshëm të frutave mesatare të specit në një varietet/hibrid të caktuar speci në pesë pikat mostrale x 100 =% e dëmit për ha.

Nëse numri i mostrave është 6, atëherë në formula në vend të numrit 5 duhet të zëvendësohet me numrin 6 të mostrave të marra për të përcaktuar humbjet, për një sipërfaqe më të madhe se 1 ha.

Për shembull: Nëse numri mesatar i frutave të specit për një varietet/hibrid të caktuar për një bimë është 10 (varieteti Somborka.) dhe numri i përgjithshëm i pikave të mostrave është 5 për ha. Një pikë e mostrës është e barabartë me 5 bimë speci. Në total 5 pika mostrale për ha, janë 25 bimë të specit që duhet të numërohen frutat e tyre të dëmtuara ose të padëmtuara - numri i përgjithshëm i frutave të specave është 250 fruta speci brenda 5 pika mostrale, por numri i dëmtuar i frutave të specave është 125, atëherë% dëmit llogaritet si më poshtë:

Sigurimet Bujqësore Tradicionale - Doracak për vlerësimin e dëmeve nga breshëri tek kultivuesit intensiv të specit

$$125/250 \times 100 = 50\%$$

Përqindja e secilës mostër duhet të shkruhet në Formularin e Inspektimit, në kolonën që i referohet mostrave. Në këtë mënyrë, të gjitha frutat e specit brenda një mostre duhet të llogariten, dhe të gjitha % e dëmtimeve për secilen mostër duhet të raportohen.

Pas vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga breshëri, për herë të parë vlerësuesi i dëmeve së bashku me fermerin shënon pikat e mostrës (secila pikë e mostrës e barabartë me 5 bimë speci) në atë zonë të goditur nga breshëri. Gjatë vlerësimit të dëmeve të parë siç përshkruhet më sipër, të gjithë frutat e specit të dëmtuar nga breshëri vjelen saktë dhe numërohen. Shënjesimi vendoset në 5 pika të mostrës me nga një shkop, të cilat fermeri nuk duhet t'i lëvizë shkopinjtë nga pikat e mostrës deri në fund të sezonit të vjeljes. Nëse breshëri ndodh përsëri në të njëjtën sipërfaqe, atëherë vlerësuesi i dëmeve vlerëson dëmet vetëm në të njëjtat pika të mostrës si nga breshëri i parë.

Për shembull, gjatë paraqitjes së breshërit për herë të parë në varietetin e njohur Somborka, gjatë vlerësimit të parë të dëmit, u konstatua se nga 25 bimë speci në të gjitha pikat e mostrës, gjithsej 125 fruta speci ishin dëmtuar. Numri i përgjithshëm i frutave të specave të planifikuar nga 25 bimë speci në ato 5 pika të mostrës do të jetë 275 fruta speci. Bazuar në këtë ne kemi përcaktuar % e dëmeve në rastin e paraqitjes së breshërit për herë të parë dhe në këtë rast, demit është 45%. Të gjithë frutat e specave të dëmtuar nga pikat e mostrës eliminohen me kujdes 100% (fermeri nuk mund të eliminojë 100% frutat e specave të dëmtuar nga e gjithë sipërfaqja, por vetëm nga pikat e mostrave) dhe kjo bëhet gjatë vlerësimit të parë.

**Shënim:** Nëse ndodhin dëmet nga breshëri në frutat e specit për herë të dytë në të njëjtën sipërfaqe, atëherë duhet të merren të njëjtat pika të mostrës si nga vlerësimi i parë i humbjes, numëroni frutat e specave të dëmtuara aktualisht, shtuar në numrin e frutave të specit të dëmtuar gjatë ndodhjes së breshërit të parë. Nga shembulli i mësipërm gjatë prezantimit të vlerësimit të humbjes nga breshëri i parë, numri i frutave të specave të dëmtuar ishte 125 copë në numrin e përgjithshëm të frutave të specave, i cili ishte 275 fruta të planifikuar varet nga varieteti ose hibridi. Gjatë ndodhjes së dytë të breshërit në të njëjtën sipërfaqe, pas vlerësimit të dëmit, si rezultat, 50 fruta shtesë speci dëmtohen nga breshëri. Pastaj kjo formulë duhet të zbatohet kur vlerësohet dëmtimi në të njëjtën zonë për specat:

**Numri i frutave të specave në pikat e mostrës të dëmtuara gjatë shfaqjes së parë të breshërit + numri i frutave të specave në pikat e mostrave të dëmtuara gjatë ndodhjes së dytë të breshërit / numri i përgjithshëm i frutave të specave të planifikuar për varietete ose hibride të caktuara =  $(125 + 50) / 275 * 100 = 175/275 * 100 = 63\%$ .**

Në fund të procesit të vlerësimit të dëmit, në këtë letër ku janë mbajtur shënimet me të gjitha llogaritjet duhet të nënshkruhet nga vlerësuesi i dëmit dhe fermeri dhe do t'i bashkëngjitet raportit të inspektimit për nevojat e gjurmimit.

#### 7.1. Klasifikimi i frutave të specit pas ngjarjes së breshërit

Frutat e padëmtuara do të konsiderohen të gjitha frutat e specit që nuk janë prekur nga breshëri. Fotografitë e mëposhtme shfaqin shembuj të frutave të padëmtuara nga breshër.



Fryt speci i dëmtuar do të konsiderohen të gjitha frutat e specit të goditura nga breshëri, duke pasur më shumë se dy lëndime (pjesë me shenja), ku ka depërtuar/lenduar kokërrza e breshërit.

Fotografitë e mëposhtme shfaqin shembuj të fryteve të dëmtuara të specit nga breshëri.

Sigurimet Bujqësore Tradicionale - Doracak për vlerësimin e dëmeve nga breshëri tek kultivuesit intensiv të specit



Fryte të dëmtuar





## 7.2. Fotografitë e Kërkueshme nga Vlerësuesi i Dëmeve

Gjatë procesit të vlerësimit të dëmit, duhet të merren numër i mjaftueshëm fotografish nga pika dhe distanca të ndryshme, në mënyrë që të tregohet sa më saktë situata reale në sipërfaqen e mbjellur me spec. Ju lutem shihni mëposhtë renditjen e fotografive që duhet të merren nga vlerësuesi i dëmeve gjatë inspektimit të sipërfaqes së mbjell me spec:

- Një fotografi gjithëpërfshirëse që tregon relievin e afërt



- Një fotografi e përqendruar nga mesi i fushës (siperfaqja e mbjellur me spec) që tregon rreshtat

Sigurimet Bujqësore Tradicionale - Doracak për vlerësimin e dëmeve nga breshëri tek kultivuesit intensiv të specit



- Fotografitë nga skajet e fushës se mbjell me spec nuk pranohen



Për secilën fushë të dëmtuar të inspektuar, një minimum prej tre fotografish nga të gjitha pozicionet duhet të merren dhe ruhen në një format elektronik dhe t'i paraqiten Kompanisë së Sigurimeve për regjistrimet e tyre.

#### 8. Përfundimi i procesit të vlerësimit të dëmeve

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit të dëmit, vlerësuesi i dëmit duhet të plotësojë të gjitha dokumentet e nevojshme dhe të mbledh të gjitha informatat që duhet t'i dorëzohen kompanisë së sigurimit për pagesën e dëmshpërblimit. Duhet të ndiqen veprimet e mëposhtme:

1. Plotësoni formularin e paraqitjes së parcelës (Shtojca 2: Forma e paraqitjes së Parcelës);
2. Plotësoni raportin e inspektimit dhe bashkangjitni letrën e nënshkruar të llogaritjeve nga fusha-terreni (Shtojca 3: Raporti i inspektimit);
3. Plotësoni raportin për llogaritjen e dëmshpërblimit (Shtojca 4: Raporti mbi Llogaritjen e dëmshpërblimit);
4. Mblidhni dhe bashkangjitni fotografi nga terreni;
5. Dërgoni të gjitha dokumentet e mësipërme në kompaninë e sigurimeve dhe informoni fermerin në përputhje me rrethanat.

### 8.1 . Kalkulimi i dëmeve/ Rezultatet e vlerësimit të dëmeve

Llogaritja e dëmshpërblimit do të bëhet në bazë të Shtojcës 4: Raport mbi llogaritjen e dëmshpërblimit.

Shtojca 1. Forma e njoftimit të dëmit

## Formulari i Njoftimit të Dëmit

Emri i të siguararit: \_\_\_\_\_

Emri i kontaktit: \_\_\_\_\_

Adresa e të siguararit: \_\_\_\_\_

Shteti: \_\_\_\_\_ Qyteti: \_\_\_\_\_ Fshati: \_\_\_\_\_

Numri i telefoni: \_\_\_\_\_

Numri i Polisës: \_\_\_\_\_

Data efektive e polisës: \_\_\_\_\_

Tipi i Polisës: \_\_\_\_\_

### Informacioni për kulturat e dëmtuara

Kultura:

Varieteti:

Data e vlerësimit të vjeljes

### Informatat rreth Kulturës

Data e ngjarjes: \_\_\_\_\_

Adresa e ngjarjes: \_\_\_\_\_

Numri i ngastrave të dëmtuara \_\_\_\_\_ Sipërfaqja e dëmtuar e ngastrës (ha)

\_\_\_\_\_

Lloji i ngjarjes:  Breshëri  Breshëri dhe Kroma e mollës

Përshkrimi i ngjarjes:

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

### **Shtojca shtesë**

Ju lutemi të merrni një kopje të secilës nga dokumentet e mëposhtme dhe bashkangjitni ato në këtë formular:

1. Kopja e dokumentit të Polisës së Sigurimit
2. Letërnjoftimi

Me anë të kësaj konfirmoj që të gjitha informacionet e mësipërme janë të vërteta dhe korrekte në të mirë të njohurive dhe besimeve të mia.

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Data dhe ora: \_\_\_\_\_

Signature: \_\_\_\_\_

Date and time: \_\_\_\_\_

## Shtojca 2. Formulari i Ngastrës form

<b>Plot Layout Form</b>	
No _____	Date "___" _____ 20__
Insured / NIF Number _____	Crop _____
Cadastral Nr _____	GPS coordinates _____
Total area of the field _____	Damaged area of the field _____
<b>Plot visualization</b>	
North	
West <span style="float: right;">East</span>	
South	
<b>Loss adjuster's comments</b>	
<b>Signatures of the members of the commission</b>	
Insured:	
Insurance company:	
Loss adjuster:	

### Shtojca 3. Raporti i inspektimit të vlerësimit të dëmeve

#### Loss Adjustment Inspection Report

Information's about the crops insured				№ _____		Information's about the Insured											
Crop				Insurance company		Insured / NIF Number											
Total insured area/Ha				№ of the contract		Address											
Date of the event				Date of the inspection		Phone number, e-mail											
<b>Section 1</b>																	
<b>Income damage information</b>																	
Cadastral Nr	Area, Ha	Damaged area, Ha	GPS coordinates of the field		Damages in each sample, %										Average damage per plot, %		
			N	E	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10			
1	2	3															6
<b>Section 2</b>																	
<b>Comments of the expert</b>																	
Insured's signature				Representative of the insurance company				Date of completion of this Report									
Full name of the insured				Full name of the representative				Contact information of the expert									
								Signature of the expert									

Annex 4. Report on calculation of indemnities

**Report on calculation of indemnity**

Data about the insured crop		№ _____		Data about Insured			
Crop		Insurance company		Name of the farm			
Total insured area				Address			
№ of the Loss Adjustment Inspection Report		№ of the contract		Phone number, e-mail			
<b>Section 1</b>				<b>Section 2</b>			
№ of the plot	Damaged area (according to LAIR), Ha	Cost of production, UER per Ha	Total cost of production, EUR	Average damage (based on LAIR), %	Deductible %	Deductible, EUR (col. 4 x col.6)	Loss per plot, EUR (col. 4 x col. 5 - col.7)
1	2	3	4	5	6	7	8
					10		
					10		
					10		
					10		
					10		
					10		
						<b>Amount of total loss, EUR (Sum col. 8)</b>	
<b>Section 3</b>							
<b>Comments of the expert</b>							
Representative of the insurance company				Date of the completion of this Report			
Full name of the representative				Contact information of the expert			

Sigurimet Bujqësore Tradicionale - Doracak për vlerësimin e dëmeve nga breshëri tek kultivuesit intensiv të specit